



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:189093
Datë: 19.03.2024
Numri i dokumentit: 05471979

C.A.P.nr.1779/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, nga Gjykatësi Individual Besnik Feka, në çështjen juridike përmbarimore të kreditores K. K. për D. me energji elektrike Sh.a, kundër debitorit V.H. M. me vendbanim në fshatin G., Komuna K., lidhur me çështjen përmbarimore kërkesa në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit V. M., ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil CPP.nr.30/2023 i datës 05.10.2023, me datë **19.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZOHET SI E PA BAZUAR ankesa e debitorit V. M. nga fshati G./Komuna e K., ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë – Departamenti i Përgjithshëm, me numër CPP.nr.30/2023, i datës 05.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Klinë – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktvendimin CPP.nr.30/2023, dt:05.10.2023, ka vendosur si në vijim:

REFUZOHET I PABAZUAR prapësimi i debitorit V. H. M., fshati Gllarevë, Komuna K., i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.334/23 i datës 11.07.2023, i lejuar nga përmbaruesit privat, Gëzim Baloku në Pejë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori V.M., për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke e kundërshtuar në tërësi aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, me propozim për gjykatën e shkallës së dytë që ankesa e debitorit të miratohet në tërësi dhe të ndryshohet aktvendimi i ankimuar me të cilin debitori do të lirohet në tërësi nga detyrimet e tij ndaj kreditorit.

Përgjigje në ankesën e debitorit nuk ka ushtruar kreditori.

Gjykatësi Individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar si dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, 17 dhe 77 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209, pika b) të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit V.M. nga fshati G./Komuna e K., rezulton e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kreditori K. K. për F. me E. E KEDS sh.a me seli në Prishtinë, ka ushtruar propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit V.M. nga fshati G./Komuna e K, për përmbartimin e borxhit në shumë prej 381.29 euro, sipas Urdhërpagesës së lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Klinë C.nr.418/2022, e datës 25.11.2022, i formës së prerë me datën 12.12.2022, ku është detyruar debitori që kreditorit t'ia paguajë shumën prej 381.29 euro, në emër të borxhit sipas aktgjykimit penal P.nr.19/2020, i datës 03.03.2022, i plotfuqishëm që nga data 06.04.2022(gabimisht është evidentuar 06.04.2020).

Përmbartuesi Privat me urdhrin për Lejimin e Përmbartimit P.nr.334/23, të datës 11.07.2023, ka lejuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit.

Kundër Urdhrit për Lejimin e Përmbartimit, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim debitori me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për Lejimin e Përmbartimit duke pretenduar se borxhi i ngarkuar është i parashkruar dhe ka kaluar afati kohor për lejimin e përmbartimit dhe se dokumenti përmbartimor nuk është i përshtatshëm për përmbartim, mbi bazën e të gjitha këtyre ka propozuar që prapësimi të aprovohet dhe të shfuqizohet Urdhëri për Lejimin e Përmbartimit.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në prapësim.

Gjykata e shkallës së parë, në përmbajtjen e arsytimit të aktvendimit të ankimuar, lidhur me mënyrën e vendosjes ka theksuar se gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të mbetet në fuqi, dhe atë për shkaqet si në vijim:

Gjykata ka vlerësuar se dokumenti përmbartues, Urdhërpagesë C.nr.396/2022 e datës 25.11.2022, me të cilin urdhërohet debitori që kreditorit t'ia paguaj, në emër të shpërblimit të dëmit, shumën 381.29 €, në bazë të së cilit përmbartuesi privat ka zbatuar përmbartimin, përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 21, 22 par.1.1, dhe neni 27 të LPP-së, për të qenë i përmbartueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbartim.

Sa i përket pretendimit se ka skaduar afati brenda të cilit mund të kërkohet përmbartimi, një pretendim i tillë është i pabazuar, pasi kërkesat e vërtetuara me vendim të formës së prerë parashkruhen për 10, vite referuar nenit 361 të LMD, ndërsa sa i përket pretendimeve të debitorit lidhur me ligjshmërinë e dokumentit përmbartues, gjykata thekson se në këtë procedurë nuk shqyrtohet ligjshmëria e dokumentit përmbartues por shqyrtohet vetëm zbatimi i procedurës

përmbartimore sipas LPP. Gjykata pati parasysh edhe pretendimet tjera, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për vendosje ndryshe.

Gjykata, analizoi pretendimet e debitorit në prapësim, dhe vlerësoi se janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, se nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e Urdhrit të Përmbartuesit Privat apo shtyrjen e zbatimit të përmbartimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par.1 pika 1 dhe nenit 71 par.1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (Ligji nr. 04/L-139) të Republikës së Kosovës

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe të njëjtin e refuzoi.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, si dhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Nga ekzaminimi i aktvendimit të goditur me ankesë, konstatohet se procedura përmbartimore ka filluar në bazë të dokumentit përmbartimor dhe atë Urdhërpaguesës C.nr.418/22, dt: 25.11.2022, e plotfuqishme që nga data 19.12.2022, , përmes së cilës është detyruar debitori që në emër të kompensimit për dëmin material në emër të shfrytëzimit të energjisë elektrike sipas aktgjykimit penal P.nr.19/2020, i datës 03.03.2022, i plotfuqishëm që nga data 06.04.2022(gabimisht është evidentuar 06.04.2020), t'ia paguaj kreditorit shumën prej 381.29 euro, si dhe shpenzimet e procedurës si në dispozitiv të dokumentit përmbartimor.

Gjykatës së Apelit, nga përmbajtja e aktvendimit të ekzaminuar me ankesë, i rezultuan të pabazuar pretendimet ankimore të debitorit, se aktvendimi i goditur me ankesë është i shoqëruar me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika n) të LPK-së, ngase aktvendimi i kundërshtuar me ankesë sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, si në përmbajtje, dispozitiv dhe arsyetim është i drejtë dhe përmban të gjitha arsyet vendimtare për një vendimmarrje të drejtë dhe të bazuar në provat si në shkresat e lëndës. Në aktvendimin e ankimuar, janë dhënë arsye të qarta dhe bindëse lidhur me refuzimin e prapësimit të debitorit, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ngase, në bazë të nenit 29 par.1, pika 1.1 dhe 2, si dhe nenin 27 par.1 të Ligjit për Procedurë Përmbartimore, në lidhje me nenin 494 par.1 të Ligjit për Procedurë Kontestimore ku përcaktohet se citoj “ *Në rastet në të cilat, sipas Ligjit mbi procedurën përmbartuese, mund të kërkohet ekzekutimi në bazë të dokumentit të besueshëm, gjykata e jep urdhërpaguesën vetëm po që se paditësi e bënë të besueshëm ekzistimin e interesit juridik për dhënien e urdhërpaguesës*”, dokumenti i besueshëm-urdhërpaguesa mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, ngase e njëjta urdhërpaguesë është lëshuar mbi bazën e aktgjykimit penal P.nr.19/2020, i datës 03.03.2022, i plotfuqishëm që nga data 06.04.2022(gabimisht është evidentuar 06.04.2020), ku debitori është detyruar në përmbushjen e detyrimit për shkak të dëmit në shumën e kërkuar si në

propozim nga vepra penale, dhe se ky dokument është i përshtatshëm për përmbardim, dhe se debitori në bazë të nenit 8 dhe 245 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 detyrohet të përmbushë detyrimin e tij karshi kreditorit, ashtu që, në rastin konkret debitori me asnjë provë nuk ka arritur që përmes prapësimit të ushtruar të vërtetoj ndonjëherë nga bazat e përcaktuara me nenin 69 dhe 71 të LPP-së.

Prandaj, Gjykata e Apelit, mbi bazën e të lartcekurave, e në mbështetje të nenit 17, 77 të LPP-së, në lidhje me nenin 194, 208, 209 pikat b) të LPK-së, gjeti se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
C.A.P.nr.1779/2023, me datë 19.03.2024

Gjyqtari Individual
Besnik Feka